

STATUTI I BASHKËSISË FETARE “VËLLAZËRIA UNGJILLORE E SHQIPËRISË”

Parime të përgjithshme

Në mbështetje të ligjit 8788 dt.03.05.2001, ligjit 8789 dt.07.05.2001, dhe të ligjit nr. 10394 dt. 10/03/2011 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe Bashkësisë Fetare “Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë” hartohet ky statut i Bashkësisë Fetare **“VËLLAZËRIA UNGJILLORE E SHQIPËRISË”**

Ky statut përcakton rregullat për funksionimin, organizimin dhe veprimtarinë e VUSH, duke u bazuar në parimet e lirisë së ndërgjegjes dhe të besimit fetar, të sanksionuara dhe të garantuara në nenet 10 dhe 24 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në marrëveshjet Ndërkombëtare të ratifikuara me ligj si dhe në ligjet e tjera në fuqi.

Bibla është rregulli autoritar për besimin dhe praktikën fetare. Të dyja pjesët e Shkrimeve të Shenjta, Dhiata e Vjetër dhe Dhiata e Re, janë zbulim i Zotit të njeriu. VUSH operon sipas parimeve Biblike të cilat pasqyrohen në Konventën e Lozanës të vitit 1974

VUSH trashëgon dhe bart vlerat kombetare të themeluesve të saj historike.

NENI 1

Forma

Sipas mënyrës së organizimit “Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë”, është një Organizatë Jofitimprurëse me anëtarësi, e themeluar me vullnetin e lirë të anëtarëve të saj.

Bashkësia Fetare “Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë”, nuk është kishë por institucion i përbërë nga tërësia e kishave, bashkimeve të kishave dhe organizatave anëtare që pranojnë, nënshkruajnë dhe zbatojnë Statutin e VUSH.

Bashkësia Fetare “Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë”, respekton pavarësinë dhe vetëqeverisjen e anëtarëve të saj.

Për realizimin e qëllimeve dhe të objektivave të saj, ajo mban lidhje me individë, organizata, shoqata e institucione të tjera, brenda e jashtë vendit, dhe ka të drejtë të anëtarësohet në shoqata homologe ndërkombëtare apo të dalë prej tyre kur për këtë votohet nga më shumë se 4/5 e të gjithë anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme.

“Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë”, është anëtare e Aleancës Ungjillore Evropiane (European Evangelical Alliance) dhe anëtare e Aleancës Ungjillore Botërore (World Evangelical Alliance).

NENI 2

Personaliteti juridik

Bashkësia Fetare “Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë” ka fituar personalitet juridik me vendimin nr. 73 datë 23.02.1995 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Me ligjin nr 10394 dt. 10/03/2011 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe Bashkësisë Fetare “Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë”, VUSH ka marrë statusin e Bashkësisë Fetare.

NENI 3

Emërtimi, Sigla, Simboli

Emërtimi i Shoqatës është Bashkësia Fetare “*Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë*” (*VUSH*). Bashkësia Fetare ka vulën e saj e cila mban mbishkrimin dhe simbolet e saj: Bibël, bojë dhe penë, dhe kjo vulë regjistrohet si e tillë.

NENI 4

Selia

VUSH e ka selinë e saj në qytetin e Tiranës, në adresë Rruga “Zenel Baboçi”, nr. 37. Ajo mund të themelojnë degë të saj në qendër ose në çdo njësi tjetër administrativo-territoriale të Shqipërisë. Këto degë nuk janë persona juridikë të veçantë, por pjesë e organizatës. Ajo ka të drejtë të themelojë degë të saj, filiale etj. jashtë territorit të Shqipërisë.

NENI 5

Kohëzgjatja

“Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë”, ushtron veprimtarinë e saj për një afat të pa kufizuar.

NENI 6

Qëllimi i Veprimtarisë

VUSH ka qëllim që të përfaqësojë, të mbajë, dhe organizojë një bashkim kombëtar të kishave, bashkimeve të kishave, fondacioneve dhe organizatave Ungjillore në Shqipëri, të cilat kanë si qëllim të përhapin Ungjillin dhe ndërtojnë dhe forcojnë besimin e Krishterë Ungjillor në Shqipëri.

NENI 7

Objektivat

“Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë”, do të realizojë qëllimin e saj nëpërmjet objektivave të mëposhtme:

a) Të vendosë, të zhvillojë dhe të ruajë marrëdhënie vëllazërore midis besimtarëve, kishave, bashkësive, bashkimeve të kishave dhe organizatave (OJF) Ungjillore të origjinave të ndryshme, anëtare të VUSH.

b) Të përgatisë dhe organizojë institucione të arsimit laik e fetar të të gjitha niveleve, duke përdorur të gjitha mjetet e nevojshme në përputhje me ligjin në fuqi.

c) Të koordinojë punën për ndihmat humanitare, materiale dhe ekonomike, për të gjithë shqiptarët, pa asnjë dallim. Ndhmat jepen në fushën e arsimit, të shëndetësisë, të kulturës, të sporteve, të asistencës sociale etj.

ç) Të ushtrojë një rol informimi dhe përfaqësimi të besimit ungjillor midis grupeve të ndryshme Ungjillore në Shqipëri, e më tej.

d) Të botojë dhe të shpërndajë libra, revista, fletëpalosje, materiale periodike e audiovizuale etj., që i shërbejnë plotësisht të qëllimeve dhe të objektivave të saj sipas rastit që do t’i paraqitet.

dh) Të organizojë veprimtari të ndryshme artistike, kulturore, shkencore, sportive etj., në përputhje me qëllimet e saj.

VUSH ushtron veprimtarinë e saj në mënyrë të pavarur nga organet dhe interesat shtetërorë.

NENI 8

Anëtarësia, të drejtat dhe detyrimet

Anëtar i VUSH, mund të jetë:

- a. Çdo kishë apo bashkësi në statutin e të cilit shprehet qartë besimi i tyre ungjillor, që pranon dhe angazhohet për respektimin e statutit të VUSH, ka jo më pak se 20 (njetzet) anëtarë të pagëzuar në ujë me frekuentim të rregullt dhe që pranojnë Konventën e Lozanës të vitit 1974.
- b. Çdo kishë apo bashkësi, që ka jo më pak se 10 (dhjetë) anëtarë të pagëzuar në ujë me frekuentim të rregullt dhe që pranojnë Konventën e Lozanës të vitit 1974, mund të aplikojnë për statusin e Anëtarit Vëzhgues. Anëtari Vëzhgues ka të gjitha të drejtat njëlloj si Anëtari i Përhershëm, përveç të drejtës për të votuar. Për periudhën që është Anëtar Vëzhgues duhet të paguajë gjysmën e kuotizacionit.
- c. Çdo organizatë apo fondacion në statutin e të cilit shprehet qartë besimi i tyre ungjillor që pranon dhe angazhohet për respektimin e statutit të VUSH dhe që pranojnë Konventën e Lozanës të vitit 1974.

VUSH nuk antarëson individë. Anëtarët e VUSH me te drejte vote duhet të jenë persona juridik jofitimprues të regjistruar sipas legjislacionit në fuqi.

E drejta e anëtarësisë në VUSH nuk mund të tjetërsohet dhe as të kalohet me anë të trashëgimisë.

Çdo anëtar i VUSH (Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë) është njëkohësisht anëtar i Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Anëtarëve dhe ka të drejtë që, nëpërmjet përfaqësuesve të vet:

- a. të marrë pjesë në votim,
- b. të marrë pjesë në të gjitha veprimtaritë e VUSH.
- c. të diskutojë dhe të japë mendimin e tij rreth çështjeve që ngrihen në Asamble.
- d. të zgjedhë dhe të zgjidhet në organet drejtuese të VUSH.
- e. të kërkojë ndryshimin e statutit të VUSH në përputhje me nenin përkatës.
- f. të kontribuojë financiarisht për mbajtjen e VUSH-it

Çdo anëtar i VUSH, përfaqësohet në Mbledhjet e Përgjithshme të Asamblesë së Anëtarëve nga jo më shumë se dy përfaqësues, nga të cilët vetëm njëri prej tyre është përfaqësues ligjor i cili ka të drejtën e votës dhe nënshkrimit të akteve në emër të anëtarit të cilin përfaqëson.

Çdo anëtar i VUSH ka për detyrë:

- a. të zbatojë dhe të mbrojë statutin nga anëtarët e saj,
- b. të marrë pjesë në veprimtaritë e përbashkëta;
- c. tju bëjë të njohur anëtarëve të kishave dhe organizatave të tyre objektivat e VUSH;
- d. të paguajë kuotizacionin një herë në vit, në fillim të vitit të ri financiar, që përkon me fillimin e punimeve të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Anëtarëve së rradhës.
- e. **Të mbrojë ata, të cilëve u shërben dhe të ketë një politikë mbrojtje aktive dhe funksionale ekuivalente me dokumentin e miratuar nga VUSH.**

NENI 9

Pranimi dhe shkarkimi i Anëtarëve

Të drejtën e pranimi të anëtarëve të rinj të VUSH dhe të përjashtimit të tyre e ka Mbledhja e Përgjithshme e Asamblesë së Anëtarëve me votimin pro të 4/5 të anëtarëve pjesëmarrës sipas quorumit të përcaktuar në këtë statut.

Mbledhja e Përgjithshme e Asamblesë së Anëtarëve, ka të drejtë të përjashtojë një anëtar në qoftë se:

- veprimtaria e tij është antikushtetuese dhe në dëm të Bashkësisë Fetare VUSH.
- veprimtaria e anëtarit është në kundërshtim me qëllimet dhe objektivat e VUSH,
- kur anëtari nuk paguan kuotizacionet për një periudhë 2 vjeçare pa arsye.
- kur veprimtaria e tij bie ndesh me memorandumimin e mirëkuptimit që është nënshkruar më parë prej tij.
- kur anëtari refuzon në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky statut.

Anëtarët gjithashtu kanë të drejtën e dorëheqjes, të cilën ia paraqesin Komitetit Ekzekutiv, i cili ia paraqet për miratim Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Anëtarëve.

Ndryshimi i statusit të një subjekti anëtar me të drejta të plota në një anëtar vëzhgues bëhet kur numri i subjektit anëtar zbret nga numri 20 anëtare të pagëzuar në ujë me frekuentim të rregullt.

Propozimi për përjashtim mund të bëhet nga çdo anëtar i Asamblesë drejtuar Komitetit Ekzekutiv, apo nga vetë Komiteti Ekzekutiv, dhe duhet bërë jo më vonë se dy muaj para takimit të Asamblesë së Përgjithshme.

Komiteti Ekzekutiv merr vendimin për propozimin për përjashtim pasi të shqyrtojë çështjen me anëtarin përkatës.

Komiteti Ekzekutiv fton kishën, organizatën (personin përfaqësues ligjor dhe në mungesë të tij person të autorizuar prej tij me shkrim tek noteri) që propozohet për përjashtim të jetë në mbledhjen e asamblesë për të dhënë mendimin e tij.

Nëse pas njoftimit me shkrim subjekti nuk pranon të paraqitet vendimi nga Asambleja mund të merret pa praninë e tyre.

KREU II

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI

NENI 10

Organet Vendimmarrëse dhe drejtuese të VUSH

Organet vendimmarrëse dhe drejtuese të VUSH janë :

1. Mbledhja e Përgjithshme e Asamblesë së Anëtarëve
2. Komiteti Ekzekutiv
3. Presidenti
4. Sekretari i Përgjithshëm

Organi më i lartë vendimmarrës është Mbledhja e Përgjithshme e Asamblesë së Anëtarëve të saj.

Në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligj dhe në këtë statut, Mbledhja e Përgjithshme e Asamblesë së Anëtarëve, mbledhet të paktën 1 herë në vit.

NENI 11

Kompetencat e Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve, si organi më i lartë vendimmarrës i VUSH, përveç çështjeve të tjera që çmon se duhet të shqyrtohen prej tij, vendos për :

- Ndryshimin e Statutit dhe Regullores së VUSH i cili realizohet me votimin pro të 4/5 të anëtarëve të VUSH të pranishëm në mbledhje.
- Pranimin dhe largimin e anëtarëve të VUSH.
- Zgjedh ose emëron anëtarët e organit më të lartë ekzekutiv, Komitetin Ekzekutiv, Presidentin dhe Sekretarin e Përgjithshëm.
- Përcakton fushat dhe programet e veprimtarisë së punës së VUSH në përputhje me statutin e saj.

- Mbikëqyr dhe kontrollon rregullisht realizimin e tyre.
- Shqyrton çështjet ekonomike, financiare dhe të administrimit.
- Miraton aktet më të rëndësishme në lidhje me buxhetin e organizatës jofitimprurëse dhe shpenzimet për vitin e ardhshëm.
- Nxjerr norma për rregullimin e veprimtarisë, të organizimit dhe të strukturës së organizatës.
- Krijon komitete të posaçme, si dhe vendos edhe për çështje të tjera të parashikuara shprehimisht në ligj.
- Merr vendim për përfundimin e veprimtarisë dhe shpërndarjen e VUSH kur kjo kërkohet nga mbi 75% e anëtarëve të Asamblesë.

NENI 12

Rregullat për mbajtjen e Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Anëtarëve

Mbledhja e Përgjithshme e Asamblesë së Anëtarëve, mblidhet të paktën një herë në vit. Mbledhja thirret jashtë radhës, me kërkesë të më shumë së gjysmës së anëtarëve, me kërkesë të Komitetit Ekzekutiv si dhe me kërkesë të Presidentit, dhe Sekretarit të Përgjithshëm.

Mbledhja njoftohet me shkrim, nëpërmjet postës së thjeshtë, postës elektronike, apo edhe nëpërmjet botimit të njoftimit në një nga gazetat e shtypit të përditshëm, të paktën 7 ditë përpara, duke bërë të ditur datën, orën, vendin e zhvillimit të saj dhe rendin e ditës.

Vendimet në Asamblenë e Përgjithshme (me përjashtim të atyre që janë paracaktuar) merren me shumicë të thjeshtë votash.

Çdo anetar ka te drejten e nje vote , e cila per Kishat ka vlere 2 ndersa per organizatat ka vlere 1.

NENI 13

Pjesëmarrja

Mbledhja e Përgjithshme e Asamblesë së Anëtarëve është e vlefshme kur në të marrin pjesë jo më pak se 2/3 e anëtarëve të saj me të drejtë vote.

Nëse në lajmërimin e parë nuk plotësohet numri i nevojshëm i anëtarëve, mbledhja e dytë mbahet brenda 45 ditëve dhe me praninë e jo më pak se 50 % të anëtarëve të saj.

NENI 14

Vendimarrja

Vendimet e Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Anëtarëve, përveç rasteve të përcaktuara ndryshe në dispozita të veçanta në këtë statut, merren me votën pro të shumicës së anëtarëve të pranishëm. Votimi është i fshehtë, përveç rasteve të veçanta kur Asambleja mund të vendosë ndryshe. Çdo vendim i Mbledhjes dhe procesverbalet përkatëse të tyre nënshkruhen nga Presidenti dhe Sekretari i Përgjithshëm.

Fillimisht , Asambleja me shumice te thjeshte vendos per emerimin e nje komisioni te numerimit te votave te perbere nga 5 anetare, i cili monitoron dhe dokumenton rezultatet e votimeve te Asamblese. Komisioni ne perfundim te votimit harton nje procesverbal i cili nenshkruhet nga te gjithe anetaret.

NENI 15

Organet Ekzekutive

VUSH, ka organe të saj ekzekutive:

- Komitetin Ekzekutiv,
- Presidentin
- Sekretarin e Përgjithshëm.

NENI 16

Komiteti Ekzekutiv

Komiteti Ekzekutiv është organi më i lartë ekzekutiv i VUSH.

Mbledhja e Përgjithshme e Asamblesë së Anëtarëve zgjedh ose shkarkon anëtarët e Komitetit Ekzekutiv me votim të fshehtë. Proçedurat e votimit përcaktohen në Rregulloren e Brendshme të VUSH.

Veprimtaria e përditshme, dhe ekzekutimi i programeve të vendosura nga organi më i lartë vendimarrës i VUSH bëhet nga organi më i lartë ekzekutiv.

Komiteti Ekzekutiv i VUSH zgjidhet në çdo tre vjet me votim të fshehtë nga Mbledhja e Përgjithshme e Asamblesë së Anëtarëve.

Komiteti Ekzekutiv përbëhet nga 7 anëtarë.

Anëtarët e Komitetit Ekzekutiv janë:

- Presidenti
- zv. Presidenti
- Sekretari i Përgjithshëm
- zv. Sekretari i Përgjithshëm
- Sekretari për Financat
- 2 Anëtarë

Çdo anëtar i VUSH, nuk mund të ketë më shumë se 1 (një) përfaqësues anëtar të Komitetit Ekzekutiv.

Anëtarët e Komitetit Ekzekutiv nuk mund të zgjidhen më shumë se dy herë radhazi në të njëjtën detyrë.

Votimi i Anëtarëve të Komitetit ka këtë renditje: zgjidhet presidenti, pas tij Sekretari i Përgjithshëm, zv/Presidenti, zv/Sekretari i Përgjithshëm, Sekretari për financat dhe 2 anëtarët.

NENI 17

Kompetencat

Komiteti Ekzekutiv drejton punën e VUSH gjatë periudhës midis dy zgjedhjeve.

Komiteti Ekzekutiv mblidhet jo më pak se një herë në 2 muaj.

Mbledhja e Komitetit mbahet kur janë të pranishëm 4 prej anëtarëve të tij dhe jo më pak se 5 anëtarë kur ka vendimarrje me votim.

Çdo anëtar i Komitetit mund të largohet nga ky pozicion kur :

- veprimtaria e tij ushtrohet në kundërshtim me Legjislacionin Shqiptar dhe me statutin e VUSH,
- për arsye shëndetsore,
- kur dorëhiqet,
- kur vdes.

Shkarkimi i një anëtari bëhet me pjesmarrjen e 3/5 të të gjithë anëtarëve të Asamblesë dhe me 4/5 e votave të anëtarëve të pranishëm për shkarkim.

Komiteti Ekzekutiv ka për detyrë:

- a. Të zbatojë vendimet e marra në Asamblesë të Përgjithshme, të marrë vendime që nevojten për përmbushjen e vizionit si dhe për zbatimin e statutit të VUSH.
- b. të ndjekë përmes Sekretarit të Përgjithshëm ecurinë e jetës së kishave anëtare të saj dhe të jetë në korrent të veprimtarive që zhvillohen në të gjithë teritorin e vendit ku ka anëtarë të VUSH .
- c. të përgatisë gjithë infrastrukturën e nevojshme për pranimet e reja në VUSH, të shqyrtojë dhe ndjek kërkesat përkatëse duke ia paraqitur në fund asamblesë së rradhës për miratim
- d. ti propozojë Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Anëtarëve, ndryshimet në statut dhe rregulloren e brendshme
- e. të përfaqësojë VUSH përpara organeve shtetërore, brenda dhe jashtë vendit përmes

Presidentit dhe/ose Sekretarit të Përgjithshëm

- f. Komiteti Ekzekutiv vendos në raste të konfliktit të kompetencave mes funksioneve të ndryshme.

NENI 18

Presidenti

Presidenti i VUSH është kryetar i Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Anëtarëve.

- a. Presidenti zgjidhet nga Asambleja e Përgjithshme me votim të fshehtë.
- b. Kandidaturat për vendin e Presidentit parapërgatiten nga Komisioni Nominues sipas propozimeve të anëtarëve të Asamblesë.
- c. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet e larta dhe jetë mbi moshën 30 vjeç.
- i. Presidenti përfaqëson VUSH përpara organeve shtetërore, komuniteteve fetare në Shqipëri, ambasadave të huaja dhe në marrëdhënie me të tretët.
- j. Cilësimi i tij është : Kryetar i Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë.
- k. Presidenti nënshkruan marrëveshje në përputhje me funksionin e tij si Kryetar i Asamblesë së Anëtarëve dhe përfaqësues i VUSH.
- l. Kujdeset për realizimin e objektivave të VUSH-it në bashkëpunim edhe me Sekretarin e Përgjithshëm.
- m. Kujdesët për ruajtjen e unitetit në komunitetin ungjillor së bashku me të gjithë anëtarët e Komitetit Ekzekutiv.
- n. Detyrohet të njoftojë me shkrim zyrën e VUSH kur largohet nga Shqipëria dhe zv/ Presidenti merr automatikisht përgjegjësitë e tij.
- o. Në rast ndërprerje te mandatit zv/ Presidenti merr vendin e Presidentit deri në fund të mandatit 3 vjeçar.
- p. Komitetit Ekzekutiv merr detyrat e Komisionit Nominues për pozicionin vakant në Komitetin Ekzekutiv.
- q. Presidenti duhet të jetë nënshtetas shqiptar

NENI 19

Zv.Presidenti

- a) Zëvendëson Presidentin në rastet e përshkruara në statut .
- b) Ndihmon Presidentin në ushtrimin e funksioneve të tij.
- c) Merr përgjegjësinë për t'u kujdesur për njërin nga aleancat rajonale.
- d) Është në mbrojtje të statutit të VUSH dhe qëllimeve të tij.

NENI 20

Sekretari i Përgjithshëm

- a) Sekretari i Përgjithshëm drejton veprimtarinë e VUSH për përmbushjen e statutit, dhe

- ekzekuton vendimet e VUSH të caktuara nga Mbledhja e Përgjithshme e Asamblesë së Anëtarëve dhe Komitetit Ekzekutiv.
- b) Ndjek me përparësi zhvillimin, ruajtjen dhe vendosjen e marrëdhënieve vëllazërore midis besimtarëve, kishave, bashkësive, bashkimeve të kishave, aleancave rajonale dhe organizatave Ungjillore të origjinave të ndryshme.
 - c) Koordinon marrëdhëniet mes anëtarëve të VUSH duke realizuar kontaktin mes tyre përmes zyrës së VUSH.
 - d) Brenda 1 viti merr kontakt me të gjitha aleancat e rretheve.
 - e) Kandidaturat për vendin e Sekretarit të Përgjithshëm parapërgatiten nga Komisioni Nominues sipas propozimeve të anëtarëve të Asamblesë.
 - f) Mbledhja e propozimeve përfundon 1 muaj përpara fillimit të Asamblesë zgjedhore.
 - g) Nuk mund të pranohen propozime të reja në ditën e zgjedhjes së Sekretarit të Përgjithshëm.
 - h) Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet e larta.
 - i) Kandidati për Sekretar i Përgjithshëm duhet të jetë pastor ose drejtues në kishën e tij dhe me një eksperiencë me shumë se 5 vjeçare në drejtim.
 - j) Nëse është drejtues në kishë dhe jo pastor kishe atëherë duhet të ketë miratimin nga pastori i tij
 - k) Zgjidhet me votim të fshehtë nga Mbledhja e Përgjithshme e Asamblesë së Anëtarëve.
 - l) Në konsultim me Presidentin, përgatit mbledhjet e zakonshme ose të jashtëzakonshme të Komitetit ekzekutiv dhe të Asamblesë së Përgjithshme.
 - m) Shqyrton dokumentacionin e kishave që kërkojnë të bëhen anëtare të VUSH-it dhe ia paraqit ato Komitetit Ekzekutiv dhe Asamblesë së VUSH për miratim.
 - n) Në bashkëpunim me Komitetin Ekzekutiv propozon dhe miraton projekt buxhetin për vitin pasardhës duke ia paraqitur këtë Asamblesë së rradhës.
 - o) Përfaqëson VUSH së bashku me Presidentin në organizatat ku aderon si: WEA dhe EEA.
 - p) Administron fondet e VUSH sipas mënyrës së caktuar nga Komiteti Ekzekutiv.
 - q) Ndjek ecurinë e librarisë së VUSH dhe bën me dije Komitetin Ekzekutiv për nevojat që paraqiten.
 - r) Njofton Komitetin Ekzekutiv kur largohet jashtë shtetit .
 - s) Në rast largimi nga detyra, zv/ Sekretari i Përgjithshëm merr vendin e Sekretarit të Përgjithshëm deri në fund të mandatit 3 vjeçar.
 - t) Komiteti Ekzekutiv merr detyrat e Komisionit Nominues për vendin e ngelur vakant.

Sekretari i Përgjithshëm, është përfaqësues ligjor i VUSH-it. Ai është person me kohë të plotë në VUSH dhe paga e tij përcaktohet nga Komiteti Ekzekutiv.

NENI 21

Zv.Sekretari i Përgjithshëm

- a. Zëvendëson Sekretarin e Përgjithshëm në rastet e përshkruara në statut .
- b. Ndihmon Sekretarin e Përgjithshëm në ushtrimin e funksioneve të tij.
- c. Merr përgjegjësinë për t'u kujdesur për njerën nga aleancat rajonale, ose një komision të caktuar.

NENI 22

Sekretari i financave

- a. Sekretari i Financave – mban dhe kujdeset për dokumentacionin financiar të VUSH. Mbikqyr mbarëvajtjen e financave në VUSH.
- b. Zgjidhet nga Asambleja e Përgjithshme dhe duhet te jetë ekonomist/e dhe me eksperiencë jo me pak se 3 vjeçare në këtë punë.
- c. Përgatit dhe paraqet raportin financiar vjetor para Asamblesë së Përgjithshme.
- d. Raporton herë pas here para Komitetit Ekzekutiv për gjendjen financiare të VUSH.
- e. Ndjekë realizimin e detyrimeve financiare të anëtarëve të VUSH.
- f. Përfaqëson VUSH në konferenca apo takimet kombëtare dhe ndërkombëtare që janë në funksion të marrdhënieve financiare.
- g. I propozon Komitetit Ekzekutiv ndalimin, shkurtimin apo ndryshimet në buxhet për projekte të ndryshme të miratuara në përputhje me gjendjen financiare.

NENI 23

Anëtarët e tjerë të Komitetit Ekzekutiv

- a. Ndihmojnë në permbushjen e detyrave të Komitetit Ekzekutiv.
- b. Drejtojnë punë të caktuara që u ngarkon Komiteti Ekzekutiv.
- c. Marrin pjese rregullisht ne mbledhjet e Komitetit Ekzekutiv.

NENI 24

Komisioni Nominues

Komisioni Nominues, zgjidhet nga Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarëve me propozimin e Komitetit Ekzekutiv dhe çdo anëtar të VUSH një vit përpara mbajtjes së zgjedhjeve të reja, me shumicë të thjeshtë votash.

Komisioni Nominues përbëhet nga 5 anëtarët përfaqësues të Asamblesë së Përgjithshme.

Komisioni Nominues nuk mund të ketë 2 anëtare nga e njëjta kishë apo grupim kishash.

Komisioni Nominues duhet të ketë njërin nga anëtarët përfaqësues të zgjedhur anëtarë të Komitetit Ekzekutiv.

Komisioni Nominues zgjedh kryetarin e saj me shumicë të thjeshtë votash .

Komisioni Nominues përgatit materialin për propozimet në përputhje me kërkesat e statutit për zgjedhjet e reja në Komitetin Ekzekutiv:

- njofton anëtarët për kandidaturat e përzgjedhura 1 muaj përpara zgjedhjeve të reja

- ia paraqet ato Asamblesë përpara votimit.

Komisioni Nominues përfundon punën e tij me përfundimin e zgjedhjeve të reja.

Çdo anëtar i Komisionit Nominues mund të rimandatohet pa kufizim.

Në rast mos zgjedhjeje në një pozicion të kandiduar atëherë kandidati i pranishëm në ato zgjedhje nuk mund të kërkohet përfshirjen e tij në kandidatura për pozicione të tjera të Komitetit Ekzekutiv.

KREU III

NENI 25

Shpërblimi i anëtarëve të organit më të lartë vendimmarrës

Anëtarët e organit më të lartë vendimmarrës, që është Mbledhja e Përgjithshme e Asamblesë së Anëtarëve, si rregull ushtrojnë funksionin e tyre pa shpërblim.

NENI 26

Përgjegjësia e anëtarëve të organeve drejtuese dhe punonjësve

Anëtarët e organeve vendimmarrëse dhe ekzekutive, si dhe punonjësit e VUSH, nuk përgjigjen për detyrimet e saj ndaj të tretëve, me përjashtim të rasteve kur gjatë ushtrimit të detyrës, me dashje ose nga pakujdesia e rëndë, i kanë shkaktuar dëm të tretëve.

KREU IV

NENI 27

Burimet dhe përdorimi i të ardhurave të VUSH

Burimet e të ardhurave të VUSH janë të ardhurat nga kuotizacioni, fonde, grante dhe donacionet e ofruara nga subjektet private ose publike, vendas ose të huaj, si dhe të ardhurat nga veprimtaria ekonomike dhe pasuritë në pronësi të saj.

VUSH siguron të ardhura nga burime që njihen nga ligji dhe bëjnë shpenzime vetëm për realizimin e qëllimit dhe objektit të veprimtarisë, për të cilin është krijuar, si dhe për drejtimin e mirëmbajtjen e pasurisë së saj.

Nuk lejohet asnjë formë e shpërndarjes së fitimit ose e përfitimit financiar dhe material nga të ardhurat dhe fitimet e VUSH prej personave që janë subjekte të statutit ose aktit themelues, përveç detyrimeve në formën e rrogave, pagesave, shpërblimeve e kompensimeve që rrjedhin nga kontrata e punës ose

kontrata të tjera të ngjashme me të ose për mbulimin e shpenzimeve të kryera me porosi dhe për llogari të saj.

VUSH, në raste të veçanta, mund ti japi ndihmë financiare anëtarëve të saj, personave të jashtëm ose subjekteve të tjera. VUSH mund te japi ndihma të tilla edhe nga fonde të dhuruara ose të vëna në dispozicion, kur donatorët kanë përcaktuar shprehimisht një të drejtë të tillë.

NENI 28

Marrëdhëniet me donatorët

Marrëdhëniet financiare, të drejtat dhe detyrimet e ndërsjellta me donatorët realizohen në përputhje me marrëveshjet përkatëse, por duke respektuar kërkesat e statutit dhe të ligjit.

Ndalohen ndihma materiale ose financiare që jepen për qëllime të kundërligjshme ose që sigurohen nëpërmjet burimeve të kundërligjshme.

NENI 29

Dhurimet dhe kontraktimet me organet shtetërore

VUSH ka të drejtë të marrë pjesë si të gjithë personat e tjerë juridikë në fushën e sipërmarrjes, të tenderimit dhe të prokurimit të granteve, të kontraktimeve dhe të shitblerjeve nga ana e organeve shtetërore të shërbimeve publike, të mallrave dhe të pasurive publike, si dhe të transferimit të shërbimeve publike dhe pasurive përkatëse nga sektori publik tek organizatat jofitimprurëse.

NENI 30

Veprimtaria ekonomike

VUSH, për realizimin e qëllimit dhe objektit të veprimtarisë së saj, sipas ligjit ka të drejtë të ushtrojë veprimtari ekonomike.

VUSH, mund të zhvillojë veprimtari ekonomike pa qënë nevoja që të krijojë një subjekt të veçantë për këtë qëllim, me kusht që kjo veprimtari të jetë në përputhje me qëllimet e saj, të jetë deklaruar si një nga burimet e të ardhurave dhe me kusht që kjo veprimtari të mos përbëjë qëllimin primar të veprimtarisë së organizatës.

Nëse VUSH, nëpërmjet ushtrimit të veprimtarisë ekonomike, realizon fitime, ato duhet të përdoren për përmbushjen e qëllimeve të përcaktuara në statut dhe në aktin e themelimit.

KREU V

NENI 31

Veteshpërndarja

VUSH shpërndahet me iniciativën e saj.

NENI 32

Likuidimi

Kur vendoset shpërndarja nga vetë VUSH, likuidimi realizohet nga një ose disa likuidatorë dhe kurdoherë përpara çregjistrimit nga gjykata.

Kur shpërndarjen e vendos gjykata, ajo cakton edhe likuidatorin, duke e veshur me kompetencat e nevojshme për zhvillimin e procedurës së likuidimit.

Në të gjitha rastet, likuidatorët kanë autoritetin dhe përgjegjësinë mbi asetet, pasurinë dhe përfaqësimin e VUSH-it, që nga dita e emërimit të tyre dhe deri në përfundimin e likuidimit.

NENI 33

Veprimtaria e likuidatorëve

Likuidatorët bëjnë vlerësimin e gjendjes financiare të VUSH dhe të pasurisë së saj në çastin e marrjes së vendimit për shërndarjen e saj, si dhe evidentojnë të gjithë kreditorët e debitorët e mundshëm.

Pas pagimit të detyrimeve që VUSH i ka shtetit dhe kreditorëve të tjerë dhe marrjes së detyrimeve nga të tretët, likuidatori vlerëson pasurinë e mbetur dhe kujdeset që kjo pasuri të shkojë në destinacionin e përcaktuar nga statuti, organi kompetent i saj, gjykata ose ligji.

Në asnjë rast nuk lejohet shpërndarje ose disponimi në favor të anëtarëve ose personave të tjerë që janë subjekte të statutit ose të aktit të themelimit të organizatës ose të të afërmeve të tyre.

Në rastet kur VUSH, ka përfituar përjashtim nga taksat apo lehtësira fiskale, donacione nga publiku ose grante shtetërore, çdo pasuri e mbetur pas pagimit të detyrimeve i shpërndahet organizatave të tjera jofitimprurëse që ndjekin qëllime të njëjta ose të ngjashme me VUSH.

NENI 34

Çregjistrimi

Kur shpërndarja është vendosur nga vetë VUSH, organi kompetent, sipas statutit, miraton raportin përfundimtar të likuidatorit dhe kërkon nga gjykata çregjistrimin e organizatës jofitimprurëse.

Në rastet kur organi kompetent i VUSH, nuk miraton raportin përfundimtar të likuidatorit ose shpërndarjen dhe likuidimin e ka vendosur gjykata në seancë gjyqësore në prani të përfaqësuesve të organizatës jofitimprurëse dhe të likuidatorit, ajo shqyrton raportin përfundimtar të likuidatorit dhe merr vendim për çregjistrimin e saj.

KREU VI

NENI 35

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet ndërmjet anëtarëve themelues, ndërmjet tyre dhe organeve vendimmarrëse dhe ekzekutive ose ndërmjet tyre dhe të punësuarve zgjidhen me mirëkuptim dhe në përputhje me statutin dhe rregullat e organizatës jofitimprurëse, në të kundërt çështja zgjidhet nga gjykata.

NENI 36

Ky statut është hartuar në gjuhën shqipe, me vullnetin e lirë e të plotë të anëtarëve të VUSH, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi dhe nënshkruhet rregullisht prej tyre.